



VENDIM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TE PANELIT

Data e miratimit: 5 shkurt 2014

Numri i lëndëve: 2012-09, 2012-10, 2012-11 dhe 2012-12

A, B, C dhe D

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 5 shkurt 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga:

Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtar ligjor
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. VENDIMI I PANELIT I DATËS 20 qershor 2013

1. Më 20 qershor 2013, Paneli ka nxjerrë vendimin rreth ankesave të parashtruara nga A, B, C dhe D në lidhje me disa incidente që kishin ndodhur në kontekst të ngjarjeve të Vidovdanit në qershor të vitit 2012. Paneli ka konstatuar se disa prej shkeljeve të pretenduara nga ankuesit në të vërtetë kishin ndodhur dhe iu ishin ngarkuar EULEX-it, që kishin rezultuar në shkeljen e të drejtave të ankuesve sipas neneve

8, 9, 11 dhe 13 të KEDNj-së, si dhe neneve 17, 18, 21, 22 dhe 2 të KNDCP-së në lidhje me të gjithë prej katër ankuesve.

2. Në vendimin e tij, Paneli ka bërë disa rekomandime për ShM-në (Shefin e Misionit) në pajtim me rregullën 34 të rregullores së punës si më poshtë:

- i. “Që shefi i Misionit të pranoj se të drejtat themelore të ankuesve janë shkelur nga EULEX-i.
- ii. Që shefi i Misionit të kërkoj nga të gjitha degët dhe organet përkatëse të EULEX-it, të cilat posedojnë informacione në lidhje me ngjarjet e Vidovdanit të vitit të kaluar, t’i sigurojnë atij një përshkrim të plotë të veprimeve të EULEX-it gjatë këtyre ngjarjeve. Mbi këtë bazë, shefi i Misionit të siguroj që çdo informacion në posedim të EULEX-it në lidhje me shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut të kryera në këtë kontekst (duke përfshirë çdo shkelje që lidhet drejtpërdrejt me zyrtarët e Policisë së Kosovës (PK)) t’iu ofrohen autoriteteve kompetente të Kosovës për veprime dhe hetime pasuese. Nëse EULEX-i më pas përcakton se rastet e tilla janë hetuar plotësisht dhe në mënyrë të duhur, EULEX-i të merr parasysht marrjen përsipër të përgjegjësisë së hetimit të këtyre rasteve.
- iii. Shefi i Misionit është ftuar që të hulumtoj me autoritetet kompetente hetuese dhe prokuroriale në EULEX:
 - a) nëse mund të ndërmerren hapa të mëtejshëm hetimor në lidhje me incidentin që përfshin ankuesit B, C dhe D; dhe
 - b) nëse rasti që lidhet me ankuesin A është duke u hetuar nga autoritetet kompetente të Kosovës, dhe në qoftë se jo, a duhet që ai të hetohet nga EULEX-i.

Paneli fton ShM t’i informoj ankuesit drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve kompetente hetuese të EULEX-it rreth rezultatit të këtyre hetimeve. Ankuesit janë të lirë për të raportuar në Panel në lidhje me ndonjë çështje të pazgjidhur atëherë kur kontaktohen nga EULEX-i.

- iv. Në lidhje me planifikimin e përfshirjes së EULEX-it në festimet e ardhshme më 28 qershor 2013, që shefi i Misionit të siguroj që autoritetet kompetente të EULEX-it:
 - a) të kryejnë një vlerësim të rrezikut me qëllim të krijimit dhe identifikimit të burimeve të mundshme të rreziqeve në mbrojtjen efektive të të drejtave të pjesëmarrësve në festimet e përmendura të Vidovdanit. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente të EULEX-it t’iu drejtohen dhe të nxjerrin mësim nga të metat e identifikuara në operacionin e Vidovdanit në qershor të vitit 2012 dhe që janë të regjistruara në këtë vendim;
 - b) të paraqesin tek shefi i Misionit një plan të hollësishëm në lidhje me përfshirjen e EULEX-it në festimet e ardhshme të Vidovdanit më 28 qershor 2013. Një plan i tillë të përfshijë një përshkrim të hollësishëm të mjeteve dhe burimeve të nevojshme për të siguruar që zyrtarët e EULEX-it të kryejnë përgjegjësitë e tyre të mandatit ekzekutiv në mënyrë efektive, në veçanti në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave të pjesëmarrësve në këto ngjaje. Kjo do të përfshijë, nëse

është e nevojshme mundësinë që zyrtarët e EULEX-it të kërkojnë përforcime. Ky plan po ashtu të përfshijë edhe mjetet e duhura të komunikimit dhe të transportit për të siguruar që ndërhyrja e shpejtë të jetë e mundur atëherë kur është e nevojshme, me qëllim të parandalimit ose të dhënies fund të shkeljeve të të drejtave të njeriut;

- c) të sigurojnë bashkërendim të duhur ndërmjet Misionit të EULEX-it në njërin anë dhe PK-së dhe autoritetet kompetente të Kosovës në anën tjetër në mënyrë që të ketë mbrojtje efektive të pjesëmarrësve në këto festime. Që EULEX-i gjithashtu të siguroj që zyrtarët e PK-së të përfshirë në çështje të tilla janë bërë plotësisht të vetëdijshëm se kryerja e dhunës ndaj pjesëmarrësve nuk do të tolerohet dhe se mekanizmat e përgjegjësisë do të zbatohen për të ndëshkuar keqbërësit;
 - d) të caktojnë një numër të mjaftueshëm të zyrtarëve të EULEX-it për këtë detyrë, në mënyrë proporcionale me seriozitetin e këtyre ngjarjeve të Vidovdanit dhe në përputhje me rrezikun potencial të shkeljeve të të drejtave të njeriut;
 - e) të ofrojnë udhëzime të qarta për të gjithë zyrtarët e policisë së EULEX-it të përfshirë në këtë operacion, në veçanti në lidhje me rrethanat në të cilat ata do të jenë të detyruar të ndërhyjnë për të mbrojtur të drejtat e njeriut të pjesëmarrësve.
- v. Në lidhje me hetimin e mundshëm dhe raportimin për sjellje të pahijshme, shefi i Misionit gjithashtu të siguroj që zyrtarët e EULEX-it të përfshirë në operacionin e Vidovdanit me kujdes të regjistrojnë çdo rast të shkeljeve të të drejtave të njeriut, për të cilat ata mund të jenë dëshmitarë ose për të cilat iu është raportuar. Që EULEX-i nga ana tjetër të hetoj secilën nga këto incidente të pretenduara dhe/ose të bart këtë informacion tek autoritetet kompetente hetuese të Kosovës me qëllim që të sigurohet hetim efektiv i secilit rast të tillë”.

3. Vendimi i tanishëm është vazhdim i vendimit të Panelit të datës 20 qershor 2013 dhe rekomandimeve të bëra aty. Kompetenca dhe autoriteti i Panelit për të përcjellë vendimet dhe rekomandimet e tij parashihet në rregullën 45 e tutje të rregullores së punës së Panelit (shih *p.sh.* vendimet për zbatimin e rekomandimeve 2011-07, *W. kundër EULEX-it*, 25 nëntor 2013; 2010-01, *Djeljaj Kazagic kundër EULEX-it*, 23 nëntor 2011 dhe 2010-07, *Blerim Rudi kundër EULEX-it*, 23 nëntor 2011).

II. INFORMACIONI I PRANUAR NGA SHEFI I MISIONIT TË EULEX-IT LIDHUR ME ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

4. Më 21 gusht 2013, shefi i Misionit (ShM) ka njoftuar Panelin lidhur me një sërë masash që i kishte ndërmarrë sa i përket rekomandimeve të Panelit.
5. Në veçanti, shefi i Misionit ka njoftuar Panelin se ai kishte kërkuar një përshkrim më të plotë të veprimeve të EULEX-it gjatë ngjarjeve si dhe operacioneve të EULEX-it në lidhje me *festimet e Vidovdanit* edhe

nga departamenti Ekzekutiv dhe nga departamenti i Përforcimit. ShM kishte kërkuar nga shefat e të dyja departamenteve dhe nga kryeprokurori i EULEX-it që të kryejnë hetime shtesë për të vërtetuar nëse kanë pasur informacion shtesë për shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut në lidhje me festimet e *Vidovdanit* gjatë vitit 2012, me synim që autoriteteve kompetente të Kosovës t'ju ofrohet një informacion i tillë në qoftë se ekzistonte.

6. ShM gjithashtu ka kërkuar nga kryeprokurori i EULEX-it që të kryej një vlerësim të mëtejshëm të lëndëve që përfshijnë ankuesit B, C dhe D në përputhje me rekomandimet e Panelit. Përveç kësaj, shefi i Misionit ka pyetur shefin e Divizionit të Përforcimit nëse incidenti që përfshin ankuesin A ishte hetuar ose ishte duke u hetuar nga autoritetet e Kosovës.
7. ShM po ashtu iu ka referuar disa masave të planifikimit dhe operacionit në lidhje në *festimet e Vidovdanit* gjatë vitit 2013. Këto masa kanë përfshirë një vlerësim të rrezikut të kryer për të identifikuar mundësinë e ripërsëritjes së shkeljeve të të drejtave të njeriut në kontekst të festimeve të *Vidovdanit* të atij viti. Duke e pasur parasysh këtë vlerësim, EULEX-i ka përgatitur një plan të hollësishëm operacional për të siguruar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të atyre që janë përfshirë në festimet e vitit 2013.
8. Udhëzimet janë lëshuar për zyrtarët policor të EULEX-it që punojnë në kuadër të atyre divizioneve rreth asaj se si pritët që ata të reagojnë kur janë dëshmitarë të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga policia e Kosovës dhe/ose nga palët private. Plani gjithashtu përfshinte mundësinë për stafin e caktuar që të kërkojnë përforcime atëherë kur është e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e pjesëmarrësve.
9. Në lidhje me bashkërendimin me homologët e tyre vendorë, shefi i Misionit ka treguar se kishte pasur një takim me zëvendës kryeministrin e Kosovës më 26 qershor 2013 dhe se EULEX-i ka qenë në kontakt me udhëheqësit fetarë serbë.
10. Masat e ndërmarra në lidhje me *Vidovdanin* kanë përmbajtur edhe përfshirjen e zyrtarëve të policisë të EULEX-it në PK për kryerjen e detyrave policore në ato ngjarje, kurse janë mbajtur konsultime të rregullta me Policinë e Kosovës. Misioni ka ofruar një listë të plotë të rekomandimeve që ishin pranuar dhe zbatuara nga PK-ja. EULEX-i gjithashtu ka përgatitur një analizë të të drejtave të njeriut, të legjislacionit vendor për konfiskimin e flamujve, emblemave dhe bluzave pa mangë, të cilat përmbajnë rekomandime që më pas ishin pranuar dhe zbatuar nga PK-ja.
11. EULEX-i më tej ka treguar se kishte ofruar një "Mjet për auditimin e të drejtave të njeriut", e cila ishte projektuar për të matur respektimin e planeve operative që përfshinin standardet përkatëse të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

12. Më tej, udhëzimet me shkrim ishin ofruar brenda EULEX-it se si të reagojnë nëse zyrtarët policor të EULEX-it janë dëshmitarë të ndonjë shkelje të mundshme të të drejtave të njeriut. Zyrtarët policor të EULEX-it janë udhëzuar që të mbajnë shënime për incidente të tilla. Stafit të EULEX-it gjithashtu iu është kërkuar që t'i udhëzojë vartësit për modalitetet lidhur me shkëmbimin e informatave përkatëse me autoritetet kompetente të Kosovës. EULEX-i ka ofruar një përmbledhje mbi monitorimin e festimeve të *Vidovdanit* gjatë vitit 2013, e cila ka konstatohet se nuk është raportuar ndonjë shkelje e të drejtave të njeriut.
13. Më 13 dhjetor 2013, shefi i Misionit ka njoftuar Panelin rreth veprimeve të mëtejshme të marra gjatë zbatimit të vendimit dhe rekomandimeve të Panelit. Shefi i Misionit ka vënë në dukje se ka qenë i njoftuar nga kryeprokurori i EULEX-it se kishte përfunduar shqyrtimi i hetimeve paraprake. Ky shqyrtim ka nxjerrë në pah se ankesat e parashtruara në Panel kanë përmbajtur më shumë informata sesa që i janë parashtruar prokurorisë në raportet penale. Gjatë hetimeve paraprake këto pohime shtesë janë vërejtur nga një ekip i përzier i prokurorëve përmes deklaratave të hollësishme të bëra nga zyrtarët e PK-së, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve. Kjo dëshmi e re është marrë parasysh atëherë kur autoritetet vendosën ta ndërpresin hetimin, pasi ai nuk përbënte ndonjë rast. Në bazë të kësaj, kryeprokurori ka pohuar se në këtë fazë nuk ishin të arsyeshëm hapa të mëtejshëm hetimor. Megjithatë, nuk është përjashtuar se hetimi mund të rihapej nëse dalin dëshmi të reja.
14. Për më tepër, EULEX-i ka dorëzuar raporte në lidhje me akuzat e ngritura nga ankuesi A në Inspektoratin Policor të Kosovës dhe në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Kryeprokurori i shtetit të Kosovës është përgjigjur se ankesat nuk mund të trajtohen nga zyra e tij për shkak të mungesës së informacionit të mjaftueshëm për të filluar një hetim penal.

III. INFORMACIONI NGA ANKUESIT

15. Ankuesit nuk kanë bërë komente mbi veprimet e ndërmarra nga shefi i Misionit.

IV. VLERËSIMI NGA PANELI

16. Paneli merr parasysh hapat e ndërmarra nga ShM që të zbatojë shumicën e rekomandimeve të Panelit. Përderisa duke vënë në dukje se shefi i Misionit shprehimisht nuk ka pranuar shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesve dhe nuk i ka informuar ankuesit për hapat e ndërmarrë nga ai, Paneli përgëzon ShM-në për ndërmarrjen e një numri hapash të rëndësishëm për të trajtuar shkeljet e regjistruara nga Paneli dhe për të vendosur masat mbrojtëse të rëndësishme në zbatim të rekomandimeve të Panelit.

17. Paneli gjithashtu ka vërejtur këto që janë paraqitur në vijim si tregues të mëtejshëm të angazhimit të ShM-së në trajtimin e problemeve të gjetura nga Paneli në vendimin e tij:

Përfshirja e EULEX-it në festimet Vidovdanit të vitit 2013

18. Paneli ka vënë re me kënaqësi se shefi i Misionit ka zbatuar të gjitha rekomandimet në lidhje me planifikimin e përfshirjes së EULEX-it në festimet e Vidovdanit më 28 qershorit 2013.
19. Paneli thekson në mënyrë të veçantë se EULEX-i ka kryer një vlerësim të rrezikut me qëllim të krijimit dhe identifikimit të burimeve të mundshme të rreziqeve në mbrojtjen efektive të të drejtave të pjesëmarrësve para festimet të Vidovdanit më 28 qershorit 2013. Në këtë kontekst, Paneli vëren se të metat në planifikim, të cilat kanë prekur festimet e vitit 2012 janë trajtuar plotësisht.
20. Një plan i hollësishëm operacional është hartuar në lidhje me përfshirjen e EULEX-it në festimet e Vidovdanit në vitin 2013. Janë përdorur mënyrat e përshtatshme të komunikimit për të siguruar ndërhyrje të shpejtë.
21. Po ashtu duket nga informacioni i dhënë në Panel se bashkërendimi i duhur mes Misionit dhe autoriteteve kompetente të Kosovës është vënë për të siguruar mbrojtjen efektive të pjesëmarrësve gjatë këtyre ngjarjeve. Po ashtu, zyrtarët e PK-së janë njoftuar siç duhet për përgjegjësitë e tyre dhe rekomandimet e EULEX-it janë zbatuar nga autoritetet e Kosovës.
22. Përderisa ShM nuk ka ofruar numra, është e qartë nga të dhënat në dispozicion të Panelit se një numër shumë më i lartë i policisë së EULEX-it ishte caktuar për festimet e Vidovdanit të vitit 2013.
23. Paneli është i bindur se EULEX-i ka dhënë udhëzime të qarta për të gjithë zyrtarët e policisë së EULEX-it, të përfshirë në operacionin e Vidovdanit të vitit 2013, në veçanti në lidhje me rrethanat në të cilat ata kërkohen që të ndërhyjë për të mbrojtur të drejtat e njeriut të pjesëmarrësve.
24. Së fundi, ShM po ashtu ka udhëzuar zyrtarët policor të EULEX-it, të përfshirë në operacion, se duhet me kujdes të regjistrojnë çdo rast të shkeljeve të të drejtave të njeriut që mund ta shohin apo që iu raportohet.

Hetimet

25. Paneli vëren se ShM-ja ka ndërmarrë një sërë hapash për të siguruar që rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut të hetoheshin.
26. Në lidhje me ankuesit B, C dhe D, Paneli përgëzon veprimet e ndërmarra nga kryeprokurori i EULEX-it për të shqyrtuar ato lëndë. Në

lidhje me ankuesin A, Paneli vëren se prokurori i shtetit të Kosovës ka marrë qëndrim se ankesat nuk duhet të trajtohen nga zyra e tij, sepse nuk kishte prova/informacion të mjaftueshme që arsyetonte nisjen e një çështje penale. Në këtë aspekt, Paneli vëren se EULEX-i nuk ka treguar nëse lënda mund ose duhet të hetohet nga EULEX-i.

27. Paneli nuk është informuar nëse ShM-ja i ka njoftuar ankuesit drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve kompetente hetuese të EULEX-it rreth rezultatit të këtyre hetimeve, siç është rekomanduar nga Paneli. Paneli fton ShM-në të konsideroj që të veprojnë ashtu nëse ajo ende nuk është ndërmarrë.
28. Pas shqyrtimit të informacionit të dhënë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Panelit,

PANELI NJEZËRI

Deklaron se ShM-ja gjatë zbatimit të rekomandimeve të Panelit ka ushtruar funksionet e tij me përkushtim dhe në mënyrë efektive.

Vendos që ta mbyllur shqyrtimin e kësaj lënde.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese